VENDIM
Nr.1009, datë 10.12.2010

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË RRJETIT KOMBËTAR ME BREZ TË GJERË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (NATIONAL BROADBAND NETWORK)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 5, pika 3, e 16 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të Rrjetit Kombëtar me Brez të Gjerë të Shqipërisë REKAB (National Broadband Network), është Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit.
2. Ngarkohet Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha